R E Z O L U T Ë

PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur domosdoshmërinë e krijimit të një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm;

- duke vlerësuar rëndësinë e racionalizimit të funksioneve të administratës publike;

- duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm dhe thellimin e reformave në shërbimin civil;

- duke synuar forcimin e institucioneve ekzistuese, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor përkatës dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil;

në mbështetje të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" neni 4, si dhe të nenit 103 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin e Këshillit të Ministrave për Gjendjen e Shërbimit Civil për vitin 2005,

konstatoi si arritje:

- është rritur cilësia e shërbimeve të ofruara nga Departamenti i Administratës Publike;

është rritur interesi për t'u punësuar në shërbimin civil dhe në administratën publike në përgjithësi;

- është zgjeruar faqja e internetit të Departamentit të Administratës Publike, duke u konfiguruar me rubrika të veçanta, sipas hapave të procedurës së rekrutimit, të parashikuara nga ligji "Statusi i nëpunësit civil";

- veprimtaria e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike ka synuar që të përfshijë sa më shumë nëpunës civilë të administratës publike qendrore dhe vendore;

konstatoi si mangësi:

- gjatë vitit 2005 një element negativ ka qenë kryerja e veprimtarive me karakter politik nga nëpunësit civilë, veçanërisht nga nivelet drejtuese, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme;

- procedura e konkurrimit ka qenë e kompromet uar për shkak të menaxhimit të fazës së tretë të konkurrimit nga eprori direkt në paracaktimin e zgjedhjes së një prej tre kandidatëve të renditur më mirë gjatë testimit;

- në administratë ka pasur shfaqje të nepotizmit;

- vlerësimi i punës për nëpunësit civilë ka qenë shumë subjektiv, nuk është zhvilluar si duhet nga institucionet, nuk i përgjigjet realitetit dhe ka kompromet uar mekanizmin e vlerësimit të përcaktuar nga ligji;

- mungesa e një drejtimi strategjik të përcaktuar dhe e objektivave të qartë nga nëpunësit drejtues të njësive organizative që ata kishin në varësi;

- pjesëmarrja jo në nivelin e kërkuar në kurset e trajnimit dhe mungesa e interesit të nëpunësve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në këto kurse;

- në përfundim të vitit 2005, jo të gjitha ministritë e kanë bërë vlerësimin e punës për nëpunësit civilë.

Për vitin 2006, Kuvendi i Shqipërisë kërkon të realizohen objektivat e mëposhtëm:

- kryerja e një reforme të thellë e të vërtetë të administratës publike, për krijimin e një rrjeti institucional që të funksionojë në mënyrë sa më të efektshme dhe të frytshme;

- rishikimi i strukturave të fryra të institucioneve dhe i përshkrimeve të punës të nëpunësve civilë, me qëllim sigurimin e realizimit të objektivave të vendosur;

- rishikimi, rregullimi dhe krijimi i një sistemi unik të pagave dhe shpërblimeve në administratën e lartë publike, në institucionet e varësisë të administratës qendrore dhe në sistemin arsimor e shëndetësor;

- përmirësimi rrënjësor i sistemit të menaxhimit të performancës, duke rritur në maksimum objektivitetin në vlerësimin e nëpunësve civilë, lidhjen e realizimit të objektivave institucionalë me rezultatet e vlerësimit individual;

- eliminimi i nepotizmit në administratën publike dhe përmirësimi i procesit të rekrutimit të nëpunësve civilë për tërheqjen e elementëve sa më të aftë profesionalisht, duke shmangur dukurinë e subjektivizmit;

- zgjerimi i fushës së veprimit të ligjit “Statusi i nëpunësit civil” dhe përfshirja në të e institucioneve të varësisë;

- mbështetja financiarisht dhe institucionalisht e veprimtarisë së Institutit të Trajnimit të Administratës Publike për trajnimin e burimeve njerëzore dhe vënien në zbatim të sistemit të vlerësimit të nevojave për trajnim, me qëllim përqendrimin e forcave trajnuese në ato fusha ku paraqitet e domosdoshme;

- tërheqja e përvojave të përparuara perëndimore në administratën publike nëpërmjet dhënies së mundësive më të mëdha studentëve shqiptarë të diplomuar jashtë vendit;

- mbështetja e zhvillimit të teknologjive të informacionit, me qëllim rritjen e transparencës së veprimtarisë së Këshillit të Ministrave, uljen e kostove operative dhe rritjen e efektshmërisë së ofrimit të shërbimeve për shtetasit shqiptarë;

- përfundimi i plotësimit të Regjistrit Qendror të Personelit nga Departamenti i Administratës Publike.

Tiranë, më 20.4.2006